

## 11. REZYME

Livadhet, hapësira të vegjetuara me bar dhe pa drunjë, janë ekosisteme të rëndësishme natyrore. Ato e pasurojnë diversitetin e përgjithshëm të një vendi, nga fakti se kanë biodiversitet të pasur, njëherit paraqesin habitat me rëndësi për shumë lloje bimore dhe shtazore.

Zakonisht, livadhet, shtrihen përgjatë rrjedhave të ujit. Zhvillohen zakonisht nëpër ultësira, prej nga edhe e marrin emrin livadhe të ultësirave. Lartësia mbidetare e këtyre livadheve në Kosovë sillet rreth 500-600 m (Krasniqi et al. 2012). Sipas hulumtimeve të zhvilluara në pjesë të ndryshme të Kosovës ato shquhen për biodiversitet të pasur (Hundozi, B.1980, Rexhepi, F. 1982, 1994, Krasniqi, E. 2003, Krasniqi, E. et al. 2012, Avdiu, A. 2012, Thaqi, L. 2014, Bajselmani, R. 2015, Kastrati, A. 2015, Mulaku, M. 2017, Gruda, E. 2019, Hoti, A. 2020).

Livadhet, gjatë pjesës më të madhe të vitit janë të gjelbra edhe pse kohepaskohe paraqiten edhe spektra me ngjyra tjera. Ato kositen së paku një herë në vit ndërsa ka raste edhe deri në dy herë. Varësisht nga reshjet në livadhe mund të ketë vërshime, që është dukuri normale për këto ekosisteme.

Ato kanë florë dhe vegjetacion të pasur. Sipas metodologjisë së Braun Blanque, në aspektin fitosociologjik, livadhet e Rrafshiti të Drenicës përfshirë edhe rrethinën e Arllatit dhe të Llapushnikut, i takojnë klasës *Molinio-Arrhenatheretea*, rendit *Trifolio-Hordetalia* dhe aleancës *Trifolion resupinati* (Hundozi, B. 1980, Rexhepi, F. 1994, Mulaku, M. 2017, Gruda, E. 2019).

Përgjatë kalon një rrjedhë ujore-përrua, përgjatëtë cilit hasen fragmente të vegjetacionit me dominim të llojeve të *shelgut* (*Salix*) të cilat në aspektin fitocenologjik i takojnë klasës *Quercus-Fagetea*, rendit *Populetalia albae* dhe aleancës *Salicion albae* (Rexhepi, F. 1994).

Prania e llojit bimor *Quercus robur* në zonën e hulumtuar, paraqet vlerë. Ky lloj u vlerësua sipas kritereve të IUCN (Millaku, F. et al. 2013), individët e të cilët njëkohësisht paraqesin mbetje të së kaluarës së vegjetacionit në zonë.

Poashtu në zonën përreth këtyre livadheve ka disa fragmente të vegjetacionit të dominuar nga *kulumria* (*Prunus spinosa*). Këto fragmente të mbetura nga e kaluara në aspektin fitocenologjik sipas Rexhepi, F. (1994) i takojnë klasës *Quercus-Fagetea*, rendit *Prunetalia spinosae* dhe aleancës *Berberidion vulgaris*. Vend me rëndësi në kuadër të diversiteti floristik, vegjetativ e peizazhor ka edhe vegjetacion të agroekosistemeve dhe ai ruderal.

Hulumtimi në terren ka rezultuar me paraqitjen e bimëve të cilat janë pjesë e florës vaskularë të këtyre livadheve ku pjesa më e madhe e tyre i takojnë grupit të *Farorëve* (*Spermatophyta*) konkretisht *Farëveshurave* (*Angiospermae*).

Qëllim i këtij hulumtimi është identifikimi dhe evidentimi i llojeve bimore të florës vaskulare në livadhet ndërmjet vendbanimeve Arllat dhe Llapushnik të komunës së Drenasit. Është e rëndësishme se deri më tani në këtë pjesë nuk ka pasur hulumtime të detajuara të florës vaskulare.

Zona e hulumtuar, livadhet ndërmjet vendbanimeve Arllat dhe Llapushnik, me lartësi mbidetare në rënje 640-610 m, shtrihet në mes të koordinatave 42°34'02.7"N 20°49'43.8"E dhe 42°34'24.8"N 20°50'57.8"E. Rrjedha e ujit që përshkon këto livadhe shkarkohet në lumin Drenicë. Këto livadhe pjesën që gjendet përgjatë rrugës magjistrale Prishtinë-Pejë, me një distancë mesatarisht 150 m nga rruga e lartpërmendur, janë të kufizuara me vendbanime kodrinore të fshatrave përkatëse, përderisa në anën veriore kufizohen me fshatin Negroc.

Është me rëndësi të theksohet se në studimin e publikuar nga Osmani, J. (2005), në kuadër të toponimeve të fshatit Llapushnik gjendet edhe Gjelbina e cila bën pjesë në kuadër të territorit të analizuar. Është një vend në livadhe në të cilën uji është i njelmët.

Pedologjinë këtyre livadheve përbëjnë substrate-toka deluviuale, konkretisht "Deluvium teltylorë" (23 / D<sub>4</sub> i d<sup>3</sup>) (Pavičević, N. et al. 1974).

Zona e hulumtuar nuk ka dallime nga pjesa tjetër e komunës sa i përket kushteve klimatike. Klima është e mesme me temperaturë mesatare vjetore 9.6 °C, dhe të reshura mesatare vjetore janë 692 mm (Kojic, M. & Pejcinovic, D. 1982, Krasniqi, E. 2006).

Faktori antropogjen e realizon veprimin e tij edhe në këto ekosisteme. Ky ndikim vërehet përmes mbeturinave të hedhura, shkarkimit të ujërave të zeza, ndërrimit të destinimit të tokës, mbetjeve plastike etj.

Në kuadër të këtij hulumtimi janë realizuar ekspedita hulumtuese në livadhet e Arllatit dhe Llapushnikut në periudhën 2022-2023 me ç'rast është mbledhur dhe sistemuar materialit floristik. Me qëllim të përcaktimit të llojeve bimore kemi përdorur tekste (përcaktues) nga autorët Demiri, M. (1983), Jordanov, D. etj. (1963-1982), Josifovic, M. etj. (1970-1986), Micevski, K. (1993-2001), Misic, Lj. & Lakusic, R. (1990), Pajazitaj, Q. (2004), Papparisto, K. et al (1988, 1992), Polunin, O. (1997), Qosja, Xh. etj. (1996), Saric, M. etj. (1992), Stevanovic, V. etj. (2012), Tutin, T. G. etj. (1964-1980), Vangjeli, J. etj. (2000) etj. Terminologjia shkencore është shënuar bazuar kryesisht në "Flora Europaea (Tutin, T. G. et al. 1964-1980). Emërtimet të llojeve bimore në gjuhën shqipe janë shënuar sipas tekstit "Fjalor i emrave të bimëve" (Krasniqi, F. et al. 2003).

Elementet floristike në kuadër të florës vaskulare të livadheve ndërmjet vendbanimeve Arllat dhe Llapushnik u takojnë 9 elementeve floristike me dominim të elementit floristik Evropaziatik. Format jetësore dominante janë hemikriptofitet.